



REPUBLIKA E SHQIPERISË



**UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS**  
**SENATI AKADEMIK**

Nr. 1270 Prot.

Tiranë, më 17/05 /2024

**VENDIM**

**Nr. 18, datë 17.05.2024**

**PËR**

**PUBLIKIMIN E KËRKESËS PËR APLIKIM PËR ANËTARË NË KOMISIONIN E  
APELIMIT TË UNIVERSITETIT POLITEKNIK TË TIRANËS**

Mbështetur në Ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Urdhrin nr. 101, datë 13.03.2024 të Ministrisë të Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për procesin zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë”, Urdhrin Nr. 37, datë 13.05.2024 të Rektorit “Për shpalljen e fillimit të procesit zgjedhor dhe datën e zhvillimit të zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin Politeknik të Tiranës”, Rregulloren “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese 2024-2028 në Universitetin Politeknik të Tiranës” neni 39, pika 2, Senati Akademik, në mbledhjen e datës 17.05.2024,

**VENDOSI:**

1. Të shpallë kërkesën për aplikim, për 5 (pesë) anëtarë të Komisionit të Apelit në Universitetin Politeknik të Tiranës.
2. Të drejtën për të aplikuar e kanë individët që plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenin 39, pika 2 të Rregullosës “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese 2024 – 2028 në Universitetin Politeknik të Tiranës”.
3. Regjistrimi i kandidatëve të interesuar, bëhet në Sekretarinë e Senatit Akademik (pranë Drejtorisë së Kërkimit Shkencor dhe Projekteve), duke filluar nga data 20.05.2024 – 22.05.2024, ora 10:00 - 12:00.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Prof. Dr. Andrea Maliqari

